



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Vau Dejes, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Sistemim asfaltim rruga e Dushasve,Laç ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45- Punë
ndertimore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 6 666 667 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë
mije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtate) Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,**
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit (2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë

ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Certifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

pika 2.3.1 duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 shkronja a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa vlera limit e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e

këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistika rrugore jodriçuese”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, perkatesisht si me poshte;

“N.P. 1 Punime germimi në tokë

*Konsiderohen **germimet**, sistemimet dhe **ndryshimet në volum** të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.*

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të **mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe*

artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, **betonarme të thjeshtë** dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese

Konsiderohet vendosja në veprë, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e **sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale** dhe komplementare.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, **punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.**

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në
---------------------	--	--	---	---

				kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Shuma 1,2 e preventivit	Niveli A	350,301.37
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime	Shuma 3, 4, 5, 6 , 9, e preventivit	Niveli A	5,404,724.32
<u>Kategoria NS-6</u>	“Sinjalistika rrugore jodriçuese”	Shuma 7 dhe 8 e preventivit	Niveli A	911,640.98
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Për kryerjen e punimeve numri i punonjësve pa perfshire stafin inxhinierik duhet të jetë **minimalisht 4 (kater) punonjës te cilet duhet të figurojne në listëpagesat e të paktën** muajit te fundit, sipas kërkesave specifike per çdo punonjes si më poshtë :

Stafi inxhinierik

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me diplome dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe te disponojë kontrate pune te vlefshme.

Pergjegjesi teknik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate me kohe pune te plote ne objekt , e cila do te bashkeshoqeroje deklaratën e subjektit.

(bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”.)

b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me kontrate pune te vlefshme dhe diplome.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se do te jete i disponueshem gjate realizimit te kontrates.

- *Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.3.4 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.4 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.*

c) 1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieri topograf duhet te jete i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune te vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën sipas preventivit dhe grafikut te punimeve (pjese e dosjes te projekt zbatimi punuar nga “LENI-ING” shpk).

Stafi i punetoreve te specializuar

a) 1 (nje) Manovratorë

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjesëse dhe të asfaltimit) duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

b) 1 (nje) shofer kamioni

Shoferët e kamionit duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur këto punonjës janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

c) 1 (nje) Betonues dhe te tjere qe lidhen me to

d) 1 (nje) punetor asfalti

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 3 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar

numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesen perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” date 10.09.1998 i ndryshuar.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zerat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese në licencën perkatese të zbatimit. **Inxhinieri ndërtimit-drejtues teknik** është përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projektit teknik *As built* si dhe projektit të mirëmbajtjes së objektit në përfundim të punimeve, pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi. Janë kërkuar inxh. ndërtimi drejtues teknik dhe inxhinier ndërtimi, në mënyrë që të mos penalizohen OE që drejtuesit teknikë i kanë të angazhuara në kontrata të tjera. Inxhinieri i ndërtimit është kërkuar që të jetë inxhinier përgjegjës i kantierit, nën mbikqyrjen dhe udhëzimet e drejtuesit teknik.

Është kërkuar **inxhinier topograf** për kryerjen e punimeve topografike për nxjerrjen e kuotave të punimeve të germimit si dhe kuotat e shtresave rrugore, sistemimin e kanaleve anësore etj.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa që punonjesit të jenë me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për deshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë

punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve që është perlllogaritur si dhe mjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

7114 Betonues dhe të tjerë që lidhen me to : Kodi i profesionit: 7114 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve "Betonues dhe të tjerë që lidhen me to", niveli i dytë i kompetencës në LKP. Betonuesi dhe të tjerë që lidhet me to ndërton korniza dhe struktura të përforcuara prej betoni ose prej allçie, përforcojnë sipërfaqet e çimentos, bën vendosjen e çimentos në mure, korniza shkallësh, tarraca, etj. Gjithashtu, ai përfundon dhe riparon sipërfaqe prej çimentoje. Ndërton struktura të përforcuara hekuri për vëllimet apo sipërfaqet që do të betonojnë sipas një projekti paraparak. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi apo të vetëpunësohet. Funksionet kryesore: "a) Njihen me projektin dhe specifikimet teknike të objektit ku do të punojnë; b) Bëjnë kontrollin paraparak të vendit të punës para fillimit të procesit; c) Bëjnë organizimin e punës me kolegët e tjerë përpara fillimit të procesit; d) Bëjnë sistemimin e materialeve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës. e) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; f) Sigurojnë sasisë e duhura të materialeve për betonin (hekur, dërrasa, skela, zhavorr, çimento, rërë, ujë etj.), sipas markave të përcaktuara në projekt; g) Realizojnë – në bashkëpunim me punëtorët e tjerë – ndërtimin e skelës që do shërbejë si plan pune për zhvillimin e operacionit; h) Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosjen e kallëpeve apo formave të ndryshme sipas projekteve paraprake; i) Vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton; j) Ndhmojnë në vendosjen e hekurit të duhur dhe lidhjen e tij; në sasinë dhe formën e përcaktuar në projektin inxhinierik; k) Realizojnë procesin e përzierjes së sasisë së duhur dhe raportet e paracaktuara të materialeve përbërëse të betonit me sasinë e duhur të ujit, me dorë ose me makineri; l) Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit; m) Bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi; n) Kryejnë nivelimin e betonit; o) Kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos; p) Bëjnë trajtimin me ujë të strukturave pas betonimit; q) Bëjnë riparimin e defekteve të vogla pas punimeve (zgavra, vrima etj.); r) Bëjnë dorëzimin e punimeve tek drejtuesi teknik i objektit duke bërë dhe shënimet përkatëse të afateve të punimit të kryer; s) Bëjnë riparime të ndryshme të sipërfaqeve të

betonuara; t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. u) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit”

7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) Kryejnë asfaltime apo punime mirëmbajtje në rrugë;

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda ekskavatorit/ fadromës, makinave ngjeshëse dhe të asfaltimit) Grupi-njësi (Profesioni) “Përdorues të makinerive të punimit të tokës dhe të tjerë të ngjashme me to” Kodi i profesionit: 8342 (Punëtorë të punimeve të tokës dhe të tjerë të ngjashme me to drejtojnë makinat për të gërmuar, kategorizuar, niveluar, zbutur dhe ngjeshur tokën ose material të ngjashme me to.) **dhe shoferat e kamionit** (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.10 Drejtues të makinave të shtrimit të rrugëve

8332.14 Shofer kamioni

8342.02 Drejtues ekskavatori

8342.05 Përdorues të rrulave (ndërtim rrugësh)

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht. e. Të jetë e/i shkathët dhe e/i zoti në përdorimin e mjeteve dhe makinerive të punës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për cdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve si më poshtë:

3.7	Shkulje rrenjeve bimeve te vogla	m2	500.0								
	Sp+p	op		100.00				12.50	30	0.42	
3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	297.0								
	Ekskavator 0.25 m3	op				32.37		4.05	30	0.13	
3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m²	m3	33.0								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		199.32				24.92	30	0.83	
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	330.0								
	Transport me auto vetshkarkuese 5 km	t/km			2,970.00			0.00		#DIV/0!	
3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	952.5								
	Sp+p	op		123.83				15.48	30	0.52	
	Grejder	op				19.05		2.38	30	0.08	
	Zhavor lumi	m3				104.8					
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	2,250.0								
	Sp+p	op		168.75				21.09	30	0.70	
	Grejder	op				33.75		4.22	30	0.14	
	Autobot	op				40.50		5.06	30	0.17	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				90.00		11.25	30	0.38	
	Stabilizant	m3				292.50					
3.711	Shtrese Stabilizanti 8 cm	m2	650.0								
	Sp+p	op		32.50				4.06	30	0.14	
	Grejder	op				13.00		1.63	30	0.05	
	Autobot	op				11.70		1.46	30	0.05	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				26.00		3.25	30	0.11	
	Stabilizant	m3				65.00					
3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri	m2	1,600.0								

	Sp+p	op		174.40				21.80	30	0.73	
	Autobitumatriçe	op				1.60		0.20	30	0.01	
	Asfaltoshtruese	op				16.00		2.00	30	0.07	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				16.00		2.00	30	0.07	
	Binder me zall e rere lavatrice	ton					176.00				
	Bitum M-3 (leng)	kg					800.00				
3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	1,600.0								
	Sp+p	op		131.20				16.40	30	0.55	
	Autobitumatriçe	op				1.60		0.20	30	0.01	
	Asfaltoshtruese	op				11.20		1.40	30	0.05	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				11.20		1.40	30	0.05	
	Asfaltobeton guri kave	ton					110.40				
	Bitum M-3 (leng)	kg					800.00				
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	1.5								
	Sp+p	op		19.20				2.40	30	0.08	
	Vibrator thellesie	op				2.46		0.31	30	0.01	
	Betonjere 500 liter	op				0.98		0.12	30	0.00	
	Cimento 32.5 N	kg					411.00				
	Rere e lare lavatrice	m3					0.69				
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					8.10				
	Uje teknologjik	l					300.00				
	Zall (granil) lavatrice	m3					1.19				
2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	1								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		3.3				0.41	30	0.01375	
3.942/1	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (paste)	ml	1,000.0								
	Sp+p	op		100.00				12.50	30	0.42	
	Sperkates boje per vizime ne rruge	op				100.00					
	Boje bikomponente (paste)	kg					840.00				

3.955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	2.00								
	Sp+p	op		1.00				0.13	30	0.00	
	Tabele rrugore D=60cm	cope				2.00					
3.616/a	F V bordura betoni 10x20cm (Per kanale uje shiu)	ml	68.0								
	Sp+p	op		54.40				6.80	30	0.23	
	Cimento 32.5 N	kg				306.00					
	Rere lumi	m3				1.22					
	Bordura betoni 15x25 cm	m				68.00					

Totali I materialeve qe do te transportohen 1800 ton
 Afati I punimeve 60 dite
 Sasia e transportuar ne dite 30 ton/dite
 Rruge kamioni ne dite 6 rruge
 Sasia max. e transportuar per 1 rruge 5 ton
 Kamionat qe nevojiten per transportin e 1 kamion 5 ton
 30 ton ne dite

Numri i manovratorëve dhe shoferëve të kamionit është përcaktuar nga numri i makinerive që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve, 6 makineri dhe 1 kamionë, si dhe mbështetur në bashkërendimin dhe mbivendosjen e proceseve të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve.

Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Eskavator	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator thellesie	1 copë	Pronësi ose me qira
Betoniere 500 l	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot	1 copë	Pronësi ose me qira
Sperkates boje per vijezime ne rruge	1 copë	Pronësi ose me qira

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit

sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, të paraqitura më sipër.

*Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) **për objektin që prokurohet**, si me poshte :*

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë*

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **60 (gjashtedhjetë) ditë kalendarike****Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

Operatori ekonomik duhet te kete nje kontrate me Landfillin Bushat,te vlefshme per depozitimn e mbetjeve inerte qe krijohen gjate punimeve.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.